



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.781/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje: Goran Milenkovič - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, dhe Blerim Dina-Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik N.T.SH “Office Trade”– Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: Ndërmarrja Tregtare Grafike “Blendi” -Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me rekuizita sportive”, me numër të prokurimit: 616-20-3577-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “KK-Prishtinë”, më datën: 28.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.T.SH “Office Trade”– Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me rekuizita sportive”, me numër të prokurimit: 616-20-3577-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “KK-Prishtinë”.

II. ANULOHET, njoftimit për dhënie të kontratës i AK “KK Prishtinë”, lidhur me aktivitetin prokurimit me titull: “Furnizim me rekuizita sportive”, me numër të prokurimit: 616-20-3577-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “KK-Prishtinë”, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që kon formë dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik: N.T.SH “Office Trade”– Prishtinë, aprovet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që kon formë nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

AR SY ET IM

Operatori ekonomik ankues N.T.SH "Office Trade"- Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 08.10.2020 me nr. 781/20, kundër propozimit për dhënën e Kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me rekuizita sportive", me numër të prokurimit: 616-20-3577-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ "KK-Prishtinë" duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 59, 60, 68, 69 si dhe Nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 14.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertin shqyrtues të prokurimit në raportin e datës: 22.10.2020, lidhur me pretendimin ankimorë të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimin ankimor

Sqarim hyrës: AK - Komuna Prishtinë gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, me vlerë të mesme. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës, përkatësisht kundër arsyetimit të eliminimit ku AK, përmes letrës standarde, ka potencuar se parashtruesi i ankesës nuk e mbulon kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional që ndërlidhet me projektet e realizuara. Kundër arsyetimit të eliminimit, parashtruesi i ankesës ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim sipas afateve të parapara me LPP. AK përmes vendimit ka refuzuar kërkesën si të pa bazuar të OE ankues, me arsyetimin si në letër standarde.

Përgjigje në pretendimet ankimore

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lendes kundrejt pretendimeve ankimore, fillimisht sqarojmë se përmes vlerësimit të ofertave OE tani ankues ishte rekomanduar për dhënie të kontratës. Pas kërkesës për ri shqyrtimit të OE tani të rekomanduar për dhënie të kontratës i njëjti është eliminuar me arsyetimin kryesor

se i njëjtit projektet e prezantuara si të realizuara i ka përfunduar jashtë periudhës kohore të kërkuar nga AK, në FDT.

AK pas kërkesës për ri shqyrtim nga parashtruesi i ankesës përmes letrës standarde ka kërkuar sqarim shtese sipas përshkrimit për kontratën e lidhur me OE “Letra Com” shpk.

Eksperti shqyrtues sqaron se AK përmes pozicionit, nr. 1, të pikës 9.1 & 9.2, ka kërkuar “OE duhet të ofrojë dëshmi se kanë përfunduar me sukses furnizime të ngjashme gjatë tri viteve të fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë jo më pak se 60 mijë euro”.

Kurse dëshmia e kërkuar dokumentare është:

Një listë të kontratave të realizuara duke plotësuar aneksin 6 të dosjes së tenderit, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerjen e furnizimeve”.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues përmes ofertës ka prezantuar Aneksin 6, përkatësisht listën e projekteve si të realizuara, me gjithsej katër (4), projekte të përshkruara, në vlerën totale prej rreth 350 000.00 €, dhe tri (3) nga to sipas përshkrimit rezultojnë të jene realizuar / përfunduar në periudhën e kërkuar nga AK (vitet 2018 dhe 2019).

OE ankues përmes ofertës si dëshmi dokumentare ka prezantuar reference, ftuara dhe dëshmi të transaksioneve bankare që ndërlidhen me OE “Letra Com”shpk, përveç kësaj i njëjti ka prezantuar edhe Aneks kontratë me të njëjtin OE, sipas përshkrimit me validitet deri me datën 30.06.2020, rrjedhimisht nuk është kërkuar sqarim shtese apo ndonjë dëshmi lidhur me Aneks kontratën apo projektet tjera të prezantuara në liste si është projekti me titull “Furnizim me material zyrtar shtypës”, të lidhur me Ministria e Drejtësisë dhe projekti tjetër “Furnizim me material sportiv, zyrtar” të lidhur me “High Tech Solution”. Një gjë e tillë është e lejueshme me dispozita ligjore përkatësisht me paragrafin 8, të nenit 39, të RRUOPP-se.

Mungon referenca/certifikata e pranimit nga lista e kontratave te prezantuara

Mund te kërkohen informata sqaruese neni 69 i LPP-së

Si prove se bashku me raport gjeni kopjen listën e kontratave të prezantuar në ofertën e OE ankues dhe kërkesën e AK-së për sqarim shtese, si dhe aneks kontratën.

Pretendimet tjera ankimore të OE ankues kanë të bëjnë kundër ofertës së OE të rekomanduar tani për dhënie të kontratës se ka një referencë të prezantuar nga UP-ja dhe nuk e ka pasur as kontratën dhe as raportet e pranimit se çka ka dërguar mall, dhe asnjë informacion të detajuar mbi faktet .

Eksperti shqyrtues sqaron se i njëjti OE , ka prezantuar listën e projekteve të realizuara, me gjithsej 3 projekte të përshkruara ndërsa si dëshmi dokumentare ka prezantuar referencën e lëshuar nga Universiteti i

Prishtinës, lidhur me projektin “Furnizim me inventar Sportiv”, në vlerë prej 174, 310.00€, rrjedhimisht e plotëson kërkesën e AK-së.

Ndërsa lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë kërkesën për ri shqyrtim e ka bërë në ditën e gjashtë (6) apo pas afatit ligjore, përkatësisht me datë 31.08.2020 e cila nuk është dashur të pranohet nga AK.

Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimit ankimor sqaron se AK me datë 25.08.2020 (e marte) kishte publikuar “Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues” Kurse, OE “Blendi” me datë 31.08.2020 (e hënë) kishte parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim pranë AK-së.

Pra, në lidhje me pretendimin e OE ankues se kërkesa për rishqyrtim është në ditën e gjashtë apo pas afatit ligjor, eksperti shqyrtues sqaron se neni 5, par 2, i LPP-së ka përcaktuar: “Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj”, rrjedhimisht i njëjti OE, kërkesën për ri shqyrtim e ka parashtruar tek AK, brenda afatit ligjor.

Përfundimisht, sipas asaj që u përshkrua si me lartë vlerësimi ynë është se AK, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave nuk e ka bërë konform nenit 59, përkatësisht nenit 7, të LPP-së. Prandaj propozimi ynë për AK, është që përmes ri vlerësimit të ofertave ti aplikoi në tërësi dispozitat e LPP-së, në mënyrë që të pasqyrohet gjendja reale e ofertave kundrejt kërkesave të dosjes së tenderit

Mendimi i ekspertit Shqyrtues:

Bazuar në sqarimet e dhëna në këtë raport propozimi ynë është që ankesa e OE ankues të aprovet pjesërisht e bazuar, propozimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet dhe lënda të kthehet në **Ri vlerësim**.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 22.10.2020 me raportin e ekspertizës.

Operatori Ekonomik me datë: 22.10.2020, me anë të parashtrësës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 28.10.2020, pa praninë e palëve kon formë nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit

të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues N.T.SH "Office Trade" – Prishtinë, se AK pas kërkesës për ri shqyrtim nga parashtruesi i ankesës përmes letrës standarde ka kërkuar sqarim shtese sipas përshkrimit për kontratën e lidhur me OE "Letra Com" shpk.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK përmes pozicionit, nr. 1, të pikës 9.1& 9.2, ka kërkuar "OE duhet të ofrojë dëshmi se kanë përfunduar me sukses furnizime të ngjashme gjatë tri viteve të fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë jo më pak se 60 mijë euro". Kurse dëshmia e kërkuar dokumentare është: Një listë të kontratave të realizuara duke plotësuar aneksin 6 të dosjes së tenderit, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerjen e furnizimeve".

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues përmes ofertës ka prezantuar Aneksin 6, përkatësisht listën e projekteve të realizuara, me gjithsej katër (4) projekte të përshkruara, në vlerën totale prej rreth 350,000.00€ dhe tri (3) nga to sipas përshkrimit rezultojnë të jone realizuar / përfunduar në periudhën e kërkuar nga AK (vitet 2018 dhe 2019).

OE ankues përmes ofertës si dëshmi dokumentare ka prezantuar referencë, fatura dhe dëshmi të transaksioneve bankare që ndërlidhen me OE "Letra Com" shpk. Përveç kësaj, i njëjti ka prezantuar edhe Aneks kontratë me të njëjtin OE, sipas përshkrimit me validitet deri me datën 30.06.2020, rrjedhimisht nuk është kërkuar sqarim shtese apo ndonjë dëshmi lidhur me Aneks kontratën apo projektet tjera të prezantuara në liste si është projekti me titull "Furnizim me material zyrtar shtypës", të lidhur me Ministria e Drejtësisë dhe projekti tjetër "Furnizim me material sportiv, zyrtar" të lidhur me "High Tech Solution". Një gjë e tillë është e lejueshme me dispozita ligjore përkatësisht me paragrafin 8, të nenit 39, të RRUOPP-së.

Mungon referenca/certifikata e pranimi nga lista e kontratave të prezantuara

Mund të kërkojnë informata sqaruese neni 69 i LPP-së.

Sa i përket pretendimeve tjera ankimore të OE ankues që kanë të bëjnë kundër ofertës së OE të rekomanduar tani për dhënie të kontratës, se ka një referencë të prezantuar nga UP-ja dhe nuk e ka pasur as kontratën dhe as raportet e pranimi se çka ka dërguar mall, dhe asnjë informacion të detajuar mbi faktet.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se i njëjti OE ka prezantuar listën e projekteve të realizuara, me gjithsej 3 projekte të përshkruara ndërsa si dëshmi dokumentare ka prezantuar referencën e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, lidhur me projektin "Furnizim me inventar Sportiv", në vlerë prej 174, 310.00€, rrjedhimisht e plotëson kërkesën e AK-së.

Ndërsa lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë kërkesën për ri shqyrtim e ka bërë në ditën e gjashtë (6) apo pas afatit ligjore, përkatësisht me datë 31.08.2020 e cila nuk është dashur të pranohet nga AK.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimit ankimor sqaron se AK me datë 25.08.2020 (e marte) kishte publikuar “Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues”. Kurse, OE “Blendi” me datë 31.08.2020 (e hëne) kishte parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim pranë AK-së. Pra, në lidhje me pretendimin e OE ankues se kërkesa për rishqyrtim është në ditën e gjashtë apo pas afatit ligjor, eksperti shqyrtues sqaron se neni 5, par 2 i LPP-së ka përcaktuar: “Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj”. Rrjedhimisht, i njëjti OE kërkesën për ri shqyrtim e ka parashtruar tek AK brenda afatit ligjor.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se AK nuk e ka bërë vlerësimin dhe krahasimin e ofertave konform nenit 59, përkatësisht nenit 7, të LPP-së. Prandaj, obligohet AK që përmes ri vlerësimit të ofertave ti aplikoj në tërësi dispozitat e LPP-së, duke kërkuar sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe të bëjë vlerësimin e tenderëve në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK-Prishtinë";
- 1x1 OE N.T.SH "Office Trade" – Prishtinë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.